



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit  
P- 84  
Prishtinë, më 1 nëntor 2012

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 1 DHE 5 NËNTOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi nënkryetari i Kuvendit **Xhavit HALITI**, ndërsa i ndihmuan **Sabri HAMITI dhe Petar MILETIQ**, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryesuesi i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryesuesi përshëndeti delegacionin e deputetëve të Parlamentit të Libisë, që ishin të pranishëm në sallë.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ramë Vataj, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Arsim Bajrami, Lutfi Haziri, Vesna Mikiq, Xhavit Haliti, Sadri Ferati, Hashim Deshishku, Halit Krasniqi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Armend Zemaj, si dhe ministrat Ramë Buja e Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Alma Lama deklaroi se e tërheq pyetjen me shifrën DO-1182, të datës 27.9.2012, të parashtruar për ministrin Enver Hoxhaj.

Deputeti Visar Ymeri parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me mospublikimin e të gjitha marrëveshjeve me konzorciumin Çalik-Limak Kosovo Energy, për privatizimin e kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim, të nënshkruara më 17 tetor 2012. Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me epilogun e kërkesës për rritjen e stafit në QKMF në Junik, në mënyrë që shërbimi shëndetësor të funksionojë 24 orë.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Xhevahire Izmaku parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me mundësinë që të ndërmerren veprime në bashkëpunim me MASHT-in për vizita sistematike të nxënësve në shkollat fillore, e cila iu referua një hulumtimi të grupit të asamblistëve të komunës së Vushtrrisë dhe Mitrovicës.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Xhevahire Izmaku.

Deputetja Xhevahire Izmaku parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me funksionimin e mirëfilltë të institucioneve parashkollore private në vend.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Xhevahire Izmaku.

Deputetja Vjollca Krasniqi parashtoi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me atë se sipas shënimeve kadastrave në emër të kujt figurojnë shumë kazerma ushtarake të cilat pas transformimit të TMK-së në FSK, nuk janë ruajtur apo të paktën nuk janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm deri në ndonjë vendim tjetër.

Ministri Agim Çeku nuk ishte i pranishëm.

Deputeti Visar Ymeri parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me atë se kur dhe me kë jeni takuar në Spitalin e Mitrovicës, që sipas deklaratës së të ashtuquajturit kryetar i Këshillit Nacional Serb, Millan Ivanoviq, i cili ka deklaruar se kryeministri dhe Bajram Rexhepi kanë pasur takime me serbët e veriut në Spitalin e Mitrovicës.

Në këtë pyetje u përgjigj ministri Bajram Rexhepi.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi, në lidhje me atë se në Ligjin për Policinë, në atë për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, as në ndonjë ligj tjetër në Kosovë, nuk ka asnjë përcaktim që lejon njësitë e inteligjencës brenda Policisë, ku jeni bazuar që e keni një strukturë të tillë.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për zëvendëskryeministren, Edita Tahiri, në lidhje me miratimin ose jo të zonjës Tahiri, që materialet që kanë të bëjnë me bisedimet me Serbinë të bëhen publike nga një produksion privat danez.

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me atë se a është pajtuar kryeministri i Kosovës, kohë më parë, në Bruksel që misioni i EULEX-it të ketë dy mandate në Kosovë, një për pjesën veriore dhe një tjetër për pjesën tjetër të Kosovës.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm.

Deputeti Liburn Aliu parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me takimin ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

## R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme
4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv
5. Votimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar
6. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi për takimin e zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e duhanit
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e pagesave
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës
14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e tre anëtarëve në Bordin për Ankesa të Mediave
15. Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës

### **3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme**

Kuvendi miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 17 dhe 18 tetor 2012.

### **4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për Projektligjin për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv, kanë përfunduar në mbledhjen plenare të datës 18 tetor 2012, mirëpo në mungesë të kuorunit nuk është proceduar me votim të këtij projektligji.

Ai më tej sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku, 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 89,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

## **V E N D I M**

Miratohet ligji nr.04/L-153 për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv.

### **5. Votimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për Projektligjin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, kanë përfunduar në mbledhjen plenare të datës 18 tetor 2012, mirëpo në mungesë të kuorumit nuk është proceduar me votim të këtij projektligji.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 91,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 0

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

## **V E N D I M**

Miratohet ligji nr.04/L-152 për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

### **6. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi për takimin e zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Thaçi ka shprehur gatishmërinë që ta informojë Kuvendin e Kosovës, për takimin e tij me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel, me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të Unionit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baroneshës Eshton.

Ai e ftoi Kryeministrin që ta marrë fjalën.

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi tha se paraqitja e tij sot para deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës, ka së paku dy qëllime kryesore.

Që të respektohet në tërësi obligimi im zyrtar për ta implementuar pikën 5 të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Kjo rezolutë na obligon neve si Qeveri dhe mua si kryeministër apo komisionet përkatëse parlamentare, që të informojmë, raportojmë rregullisht për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, në Kuvendin e Kosovës.

Ky proces ka filluar në Bruksel, me mbështetje të fuqishme edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Fillimit të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë, i ka paraprirë konsulta gjithë-kosovare dhe mbështetja e gjerë politike.

Ky proces është plotësisht në përputhje me procesin e integriteteve evropiane dhe përmbushjes së kriterëve të *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, si dhe përmbushjen e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të vitit 2010 e cila verifikon, pa asnjë fije dyshimi mendimin e GJND-së për legalitetin dhe legjitimitetin e Deklaratës së Pavarësisë dhe njëkohësisht nis procesin e dialogut ndërmjet dy shteteve si pjesë të procesit të integriteteve evropiane.

Pas aprovimit të Rezolutës, kam marrë një ftesë zyrtare për të shkuar për takim zyrtar bilateral me zëvendëspresidenten e Komisionit Evropian dhe njëherësh Përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baroneshën Eshton.

Përveç ftesës për takime bilaterale, baronesha Eshton ka konsideruar sa tashmë janë krijuar kushtet adekuate për të ndërmjetësuar, lehtësuar një takim të përbashkët, të nivelit të lartë ndërshtetëror ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë.

Gjatë takimeve të ndara që i kemi pasur në Bruksel me baroneshën Eshton, ajo na i ka prezantuar çështjet që ajo do të dëshironte t'i diskutonte në takimin e përbashkët.

Ato çështje kanë qenë plotësisht të pranueshme, prandaj si rrjedhojë baronesha Eshton na ka ftuar në takimin e përbashkët, të ndërmjetësuar nga ajo dhe me mbështetje të fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky takim është zhvilluar në Zyrën e baroneshës Eshton.

Ky takim i parë i këtij niveli të lartë shënon fillimin e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve të pavarura, me synimin e mbylljes së kapitullit të errët të së kaluarës dhe hapjen e kapitullit të paqes, bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë dhe integriteteve euroatlantike.

Kam kërkuar garanci ndërkombëtare që ky proces të jetë i strukturuar dhe krejtësisht i barabartë në nivelin ndërshtetëror për Kosovën dhe Serbinë, në reciprocitet të plotë politik dhe në hapjen e rrugëve integruese për Kosovën.

Përfshirja e drejtpërdrejtë e kreut të diplomacisë amerikane dhe evropiane na garanton se procesi i dialogut është me përkrahje strategjike për Kosovën, për funksionalizimin e plotë, konsolidimin dhe fuqizimin e shtetit të Kosovës, Kosovës së re, Kosovës së evropiane.

Takimi u fokusua në kornizën e bisedimeve dhe natyrën e temave.

Çështjet që janë ngritur nga baronesha Eshton dhe diskutuar nga dy kryeministrat, i shtetit të Kosovës dhe atij të Serbisë, në takimin e parë janë:

- Zbatimi në praktikë i të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tani ndërmjet shtetit të Kosovës dhe atij të Serbisë;
- Zbardhja e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës;
- Zhbërja dhe largimi i plotë nga Kosova, i strukturave paralele të sigurisë, të financuara nga Serbia;
- Mospengimi për Kosovën për anëtarësim në organizatat dhe forumet ndërkombëtare, nga Serbia.
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë;
- Përmbyllja e procesit të decentralizimit në Kosovë, që nënkupton domosdoshmërinë e formimit të komunës së re, atë të Mitrovicës së veriut dhe mbajtjen e zgjedhjeve të lira në veri të vendit;
- Arritja e marrëveshjeve në fushën e telekomunikacionit dhe energjisë, sipas standardeve evropiane, si dhe mundësinë e shpejt të hapjes së zyrave ndërlidhëse të Republikës së Kosovës, në Beograd dhe anasjelltas.

Konkluzioni i takimit të parë ishte pajtimi për t'i adresuar temat e diskutuara dhe vazhdimi i takimeve tjera.

Besoj se takimi i ardhshëm do të ndodhë gjatë këtij muaji dhe jam i sigurt se do të jetë më përmbajtjesor.

Ju ftoj që t'i lëmë prapa dhe anash interesat partiake, të koncentrohemi mbi të gjitha në interesat shtetërore dhe vizionin për të ardhmen dhe të bashkëpunojmë për integritet evropiane.

Pastaj, kryesuesi fjalën ua dha deputetëve të Kuvendit.

Lidhur me fjalimin e kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, diskutuan këta deputetë: **Arsim Bajrami, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Adem Grabovci, Ramiz Lladrovci, Sabri Hamiti, Albin Kurti, Muhamed Mustafa, Idriz Vehapi, Afrim Kasolli, Hydajet Hyseni, Arben Gashi, Bekim Haxhiu, Sadri Ferati, Gëzim Kelmendi, Ali Sadriu, Lutfi Haziri, Halit Krasniqi, Xhevahire Izmaqi**, si dhe zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** dhe ministri **Enver Hoxhaj**, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund, kryesuesi e deklaroi të përfunduar debatin për këtë pikë.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë**

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë.

Ministri Ferid Agani tha se ky projektligj themelon odat e profesionistëve shëndetësorë si organizata të pavarura dhe profesionale. Projektligji rregullon edhe anëtarësimin në oda, kompetencat e odave të profesionistëve shëndetësorë, organizimin e tyre, mbajtjen e regjistrat

të anëtarëve, organet e odave, përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve, burimet e financimit të odave të profesionistëve shëndetësorë dhe çështjet tjera që lidhen me fushëveprimin e tyre. Me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore, për ushtrimin e këtij misioni formohen: Oda e Mjekëve, Oda e Stomatologëve, Oda e Farmacistëve, Oda e Infermierëve, e Mamive dhe e teknikëve të tjerë shëndetësorë.

Në vazhdim ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka - në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Salihe Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nazane Breca - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gëzim Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jelena Bontiq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe: Aurora Bakalli, Bekim Haxhiu, Ardian Gjini, Salih Morina dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për odat e profesionistëve Shëndetësorë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

|                |     |
|----------------|-----|
| Për-----       | 47, |
| Kundër-----    | 5,  |
| Abstenime----- | 3.  |

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e duhanit**

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për kontrollin e duhanit.

Ministri Ferid Agani tha se me qëllim të mbrojtjes të shëndetit publik nga pasojat shkatërruese shëndetësore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit, me këtë projektligj përcaktohen masat për ndalimin, kufizimin e përdorimit të produkteve të duhanit, përbërësve të duhanit, parandalimin e pasojave të dëmshme nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për kontrollin e duhanit.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për kontrollin e duhanit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka - në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Flora Brovina - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Thaçi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gëzim Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar “6+” si dhe: Ramiz Lladrovci, Nazane Breca, Aurora Bakalli, Bekim Haxhiu, Armend Zemaj, Ardian Gjini, Sadri Ferati, Jeton Svirca, Hashim Deshishku, Muhamet Mustafa, Sali Morina, Agim Kuleta dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi Xhavit Haliti konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votimin e kësaj pike.

Kryesuesi tha se vazhdimi i saj do të bëhet më 2 nëntor 2012, në orën 10.

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 18:30 minuta.

### **E premte, 2 nëntor 2012**

#### **Vazhdimi i mbledhjes plenare**

Mbledhjen e kryesoi nënkryetari i Kuvendit, **Xhavit HALITI**.

Kryesuesi, në mungesë të kuorumit për të vazhduar me punimet e mbledhjes plenare, deklaroi se ajo shtyhet të hënën, më 5 nëntor 2012.

### **E hënë, 5 nëntor 2012**

#### **Vazhdimi i mbledhjes plenare**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Sabri HAMITI**.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë dhe e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 1 nëntor 2012.

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re dhe Grupi Parlamentar SLS, kanë propozuar zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kryetari kërkoi nga deputetët që nëpërmjet votimit formal, me ngritje dore të deklarohen për propozimet e lartshënuara

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash

## **V E N D O S I**

1. Deputeti Danush Ademi emërohet anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në vend të deputetit Emin Gërbeshi;

2. Deputetja Sevdije Lama emërohet anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Muhamet Mustafa;
3. Deputeti Gëzim Kelmendi emërohet anëtar në Komisionin për Legjislacion, në vend të deputetit Amir Ahmeti;
4. Deputeti Gëzim Kelmendi emërohet anëtar në Komisionin për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në vend të deputetit Amir Ahmeti;
5. Deputeti Boban Todoroviq emërohet anëtar në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Etem Arifi,

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet sipas pikave të mbetura të rendit të ditës.

### **8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e duhanit**

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në mbledhjen e 1 nëntorit, ndërsa në mbledhjen e sotme duhet të votohet për këtë projektligj.

Ai e hodhi në votim Projektligjin për kontrollin e duhanit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,  
Kundër----- 4,  
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për kontrollin e duhanit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin, brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

### **9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale**

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Në emër të Qeverisë së Kosovës askush nuk e paraqiti ekspozenë për Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Kryetari konstatoi se kjo pikë do të shqyrtohet në mbledhjen plenare të radhës.

### **10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e pagesave**

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për sistemin e pagesave.

Ministri Bedri Hamza tha se ky projektligj rregullon licencimin, operimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës në përputhje me ligjin nr.03/L-209, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Më pas ai theksoi se ky projektligj adreson rregullat sipas të cilave autorizohen institucionet e pagesave, kushtet dhe standardet për ofrimin e shërbimeve të tilla si dhe mjetet dhe procedurat sipas të cilave BQK-ja i ushtron kompetencat e saj mbikëqyrëse.

Në vazhdim ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për sistemin e pagesave. Pastaj, kryesuesi Sabri Hamiti hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për sistemin e pagesave.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Naser Osmani - në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hasime Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”si dhe Hashim Deshishku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për sistemin e pagesave.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

|                |     |
|----------------|-----|
| Për-----       | 71, |
| Kundër-----    | 1,  |
| Abstenime----- | 0.  |

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për sistemin e pagesave. Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë Projektligjin, brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike**

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për zonat ekonomike.

Ministrja Mimoza Kusari-Lila tha se ky projektligj trajton zhvillimin e zonave ekonomike që të mundësohen investimet e reja, aktivitetet industriale dhe prodhimi për eksport, lehtëson hyrjen e mallrave dhe kapitalit, aplikimin e teknologjisë së përparuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përfitimin e investimeve të huaja dhe shkëmbimeve tregtare.

Në vazhdim ajo u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për zonat ekonomike. Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për zonat ekonomike.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Sala Berisha-Shala - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hashim Deshishku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Xhevdet

Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejane Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Zenun Pajaziti, Aurora Bakalli, Imri Ahmeti, Muhamet Mustafa, Haki Demolli, Sadri Ferati, Ardian Gjini dhe ministrja Mimoza Kusari-Lila, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për zonat ekonomike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 46,  
Kundër----- 19,  
Abstenime----- 9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për zonat ekonomike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri , si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë Projektligjin, brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme**

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit funksional për Zhvillimit Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 dhe amendamentin nr. 32.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

### **13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës**

Deputeti Liburn Aliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale tha se si komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës, dhe Kuvendit i kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni funksional.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Salihe Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nazane Breca - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gëzim Kelmendi - në emër të Koalicionit Kosova e Re, si dhe: Rita Hajzeraj-Beqaj, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Nijazi Idrizi, Jeton Svirca, Visar Ymeri, Muhamet Mustafa, Salihe Mustafa dhe ministri Nenad Rashiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi Sabri Hamiti konstatoi se në diskutimet e disa deputetëve, pati vërejtje në rekomandimet nr. 1, nr. 4 dhe nr. 5. Ai kërkoi që në lidhje me këtë të deklarohet përfaqësuesi i Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Liburn Aliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deklaroi se Komisioni nuk i pranon vërejtjet e paraqitura në diskutim.

Diskutimi i plotë i kryesuesit të mbledhjes plenare, Sabri Hamiti dhe ai i deputetit Liburn Aliu, janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

|                |     |
|----------------|-----|
| Për-----       | 61, |
| Kundër-----    | 3,  |
| Abstenime----- | 7.  |

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

### **V E N D I M**

Miratohet Raporti me rekomandime i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës nr. 03/L-212.

### **14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e tre anëtarëve në Bordin për Ankesa të Mediave**

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave, pas intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave, Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet për procedim dhe miratim.

Në emër të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave, arsyetimin e rekomandimit e paraqiti deputeti Sadri Ferati.

Ai i propozoi Kuvendit që për shkak të racionalizimit të kohës, kryetar i Bordit për Ankesa të Mediave të zgjedhet kandidati i cili fiton më së shumti vota nga tre anëtarët e këtij bordi.

Kryetari kërkoi nga Kuvendi deklarinimin e deputetëve për propozimin e deputetit Sadri Ferati.

Kuvendi miratoi propozimin e nënkryetarit të Komisionit ad hoc që kandidati i cili fiton më së shumti vota, nga tre anëtarët e këtij bordi, të emërohet kryetar i Bordit për Ankesa të Mediave.

Në vazhdim, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Ganimete Musliu,
2. GP LDK - Vjollca Krasniqi,
3. GP Vetëvendosje – Albana Gashi,
4. GP AAK - Kimete Bajraktari,
5. GP Koalicioni Kosova e Re - Jeton Svirca,
6. GP SLS - Milivoje Stojanoviq,
7. GP 6+ - Albert Kinolli

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Kryetari më pas konstatoi se Kuvendi, emëroi anëtarët në Komisionin votues për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave dhe për zgjedhjen e kryetarit të Bordit për Ankesa të Mediave.

Komisioni votues vazhdoi me procedimin për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti Ganimete Musliu.

Ajo konstatoi se Komisioni votues, pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit, për përzgjedhjen e anëtarëve në Bordin për Ankesat e Mediave, në mbledhjen plenare të mbajtur më 5 nëntor 2012, konstatoi si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë.

Të pavlefshme janë 7 fletëvotime.

- Për Avdi Dinaj, kanë votuar 11 deputetë,
- Për Nesrin Lushtën, kanë votuar 8 deputetë,
- Për Albion Kemendin, kanë votuar 54 deputetë,
- Për Emine Kaçikun, kanë votuar 23 deputetë,
- Për Daut Krasniqin, kanë votuar 57 deputetë,
- Për Sylejman Klinakun, kanë votuar 55 deputetë.

Komisioni e ka nënshkruar Raportin dhe ia dorëzon Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të deklaruar nga Komisioni votues, Kuvendi merr këtë:

## V E N D I M

**I.** Anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave, emërohen:

1. Daut Krasniqi,
2. Albion Kelmendi,
3. Sylejman Klinaku.

**II.** Daut Krasniqi emërohet kryetar i Bordit për Ankesa të Mediave.

**III.** Mandati i të emëruarve nga pika **I. dhe II.** të këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.

### **15. Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës**

**Kryetari**, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2012, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen e sotme plenare t’i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve.

Në vazhdim, kryetari i ftoi kryetarët , përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t’i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad-hoc.

Grupet parlamentare i propozuan këta anëtarë:

GP i PDK-së i propozoi deputetët Xhevahire Izmaqi dhe Idriz Vehapi;

GP i LDK-së i propozoi deputetët Lirije Kajtazi dhe Sadri Ferati;

GP i LV e propozoi deputeten Alma Lama;

GP i AAK-së e propozoi deputeten Teuta Haxhiu;

GP i Koalicionit Kosova e Re e propozoi deputeten Emilija Rexhepi;

GP i SLS-së e propozoi deputetin Milivoje Stojanoviq, si dhe

GP “6+” e propozoi deputetin Albert Kinolli.

Pas këtyre propozimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 55,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

**I.** Formohet Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku, nga GP PDK, kryesuese,
2. Idriz Vehapi nga GP PDK, anëtar,
3. Lirije Kajtazi nga GP LDK, anëtare,
4. Sadri Ferati nga GP LDK, anëtar,
5. Alma Lama nga GP Vetëvendosje, anëtare,
6. Teuta Haxhiu nga GP AAK, anëtare,
7. Emilija Rexhepi nga GP Koalicioni Kosova e Re, anëtare,
8. Milivoje Stojanović nga GP SLS, anëtar,
9. Albert Kinolli nga GP “6+”, anëtar.

**II.** Komisioni parlamentar ad-hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të ligjit nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, duhet t’i shqyrtojë dhe t’i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për anëtarë të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

\*\*\*

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 16:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Përgatiti: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*